

## Vendim nr. 162 datë 16.07.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Genti Ibrahimimi,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 16.07.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 8 (G) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **GENCI DUKA**, përfaqësuar nga avokate Mimoza Kurti, me prokurë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 37, datë 09.02.1995 të ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave; nr. 11682, datë 03.12.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 3875, datë 27.11.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2023-4806, datë 15.11.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, i ndryshuar (*ligji nr. 9235/2004*); ligji nr. 8337, datë 30.04.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”; ligji nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar; ligji nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar; ligji nr. 8577, datë

**10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi dhe pala e paditur, në procesin e kundërshtuar prej tij me këtë ankim kushtetues individual, rezultojnë se janë në një marrëdhënie të posaçme midis tyre, pasi të gjithë janë trashëgimtarë ligjorë të trashëgimlënësit G.SH. Gjithashtu, rezultojnë se ndërmjet tyre ka lindur një konflikt pronësie për një pronë të ndodhur në qytetin e Tepelenës, për të cilën janë nxjerrë disa vendime nga ish-Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe gjykatat të juridiksionit të zakonshëm.

2. Për këto arsye, pala e paditur në proces i është drejtuar rrugës gjyqësore me kërkesëpadinë me objekt anulimin e vendimit nr. 458 datë 22.12.2008 të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Gjirokastrë dhe vendimit nr. 319 datë 4.10.2010 të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, si edhe ndryshimin e vendimit nr. 56, datë 15.12.2005 të ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Qarkut Gjirokastrë.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 11682, datë 03.12.2012, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, sipas objektit të saj. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 3875, datë 27.11.2014, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-4806, datë 15.11.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk përmbante asnjë prej rasteve të parashikuara në nenin 472 të Kodi i Procedurës Civile (*KPC*).

4. Në datën 02.05.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 07.06.2024.

**II**

**Pretendimet e kërkuesit**

5. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, duke argumentuar si vijon:

- 5.1. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë vendim në shkelje flagrante të neneve 8, 16, 29 dhe 31 të KPC-së dhe vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë ka keqinterpretuar ligjin, vendimet e mëparshme të gjykatave dhe ka dhënë vendim në shkelje të dispozitave ligjore të ligjit nr. 9235/2004. Ajo gjykatë ka dhënë vendim në shkelje të vendimeve të Këshillit të Ministrave, të cilat nuk vërtetojnë pretendimet e paditësve dhe nuk ka shqyrtuar të gjitha dokumentet arkivore të paraqitura nga kërkuesi.
- 5.2. Gjykata e apelit ka dhënë një vendim të kopjuar nga gjykata e shkallës së parë, duke cenuar të drejtën e pronës. Ajo gjykatë ka keqinterpretuar çeljen e trashëgimisë të bërë me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 8237.
- 5.3. Janë shkelur nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës, të cilat garantojnë të drejtën e pronës. Shkeljet procedurale dhe materiale të gjykatave të sipërcituara kanë cenuar këtë të drejtë (të drejtën e pronës) dhe kanë krijuar konflikte të mëtejshme.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

6. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

7. Për sa më lart, Kolegji fillimisht vlerëson se duke qenë se kriteret janë të natyrës kumulative, në rastin konkret ai do të ndalet vetëm në kriterin *ratione materiae*, pa pasur nevojë t’i analizojë me radhë kriteret e shqyrtimit paraprak.

8. Në këtë këndvështrim, në lidhje me kriterin e legjitimitimit *ratione materiae*, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, Kolegji konstaton se ai verifikohet në drejtim të përmbajtjes dhe natyrës së pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues individual. Në këtë kuptim, Gjykata ka theksuar se

kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre nuk përbën lëndë kushtetuese. Çështjet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, të cilat hyjnë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme, mund të merren në konsideratë në gjykimin kushtetues vetëm nëse cenohen të drejta ose liri kushtetuese themelore. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, që dallon nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 24, datë 09.04.2024; nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 5, datë 09.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Për sa më sipër, referuar argumenteve të paraqitura nga kërkuesi në mbështetje të pretendimeve të tij për cenimin e procesit të rregullt ligjor, Kolegji vëren se ato, në thelb, kanë të bëjnë me çështje të interpretimit e zbatimit të ligjit dhe, si të tilla, nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, por në atë gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Nga ana tjetër, Kolegji konstaton se në lidhje me këto pretendime kërkuesi nuk ka arritur të provojë se si vendimet/qëndrimet e kundërshtuara prej tij kanë cenuar procesin e rregullt ligjor. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuesit nuk janë argumentuar nga pikëpamja kushtetuese, ndaj ato nuk mund të merren në shqyrtim.

10. Si përfundim, bazuar në të gjithë arsyetimin e mësipërm, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk i plotëson kriteret për kalimin për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.